




MARRËVESHJE PËR BASHKËPUNIM – (MpB)

në mes të

Iniciativa për Zhvillimin e Bujqësisë së Kosovës me regjistrim
Nr: 5200122-6 – në tekstin e mëtejme i referuar si “IADK”



dhe

Kuvendit Komunal të Mitrovicës në tekstin e mëtejme referuar si “Komuna e Mitrovicës”

I. Lënda e MpM

“IADK”-ja dhe “Komuna e Mitrovicës” pajtohen të rregullojnë një bashkëpunim të afërt me qëllim të ruajtjes së vazhdimësisë së projekteve bujqësore të realizuara nga “IADK”-ja në Komunën e Mitrovicës, bashkëfinancimin e projekteve (granteve), kryerjen e shërbimeve këshillimore për fermerët nga komuna dhe “IADK”-ja si dhe në përpilimin dhe realizimin e projekteve të reja në këtë komunë.

Kjo MpB ka qëllimin të përshkruajë bashkëpunimin në mes të “IADK”-së dhe “Komunës së Mitrovicës” gjatë periudhës 2019-2021 për pikat, të drejtat dhe detyrat për secilën palë të kyçur, ku si qëllim i fundit është ndihma dhe përkrahja e fermerëve të cilët do të jenë në gjendje të prodhojnë për nevoja të veta dhe për tregun.

Palët e lart cekura pajtohen që MpB-ja të përmbajë këto obligime dhe përgjegjësi:

II. Bashkëfinancimin e projekteve të “IADK”-së në investimet direkte në sektorin e bujqësisë

- “Komuna e Mitrovicës” në bashkëpunim me “IADK”-në do t’i koordinojnë investimet në sektorin e bujqësisë;
- “Komuna e Mitrovicës” do të bëjë bashkëfinancim në projektet e “IADK”-së në investimet direkte tek fermerët në Komunën e Mitrovicës nga projektet e aprovuara nga donatorët/partnerët e IADK-së për çdo vit sipas planit vjetor. (shih aneksin I);
- “Komuna e Mitrovicës” së bashku me “IADK”-në do të përzgjedhin projektet për bashkëfinancim të cilat do të detajohen në aneksin I edhe për vitet e ardhshme deri në 2021 dhe do t’i bashkëngjiten kësaj MpB ku “Komuna e Mitrovicës” në fillim të çdo viti kalendarik do të nënshkruajë anekset përkatëse .





- Pagesa e bashkëfinancimit të IADK-së nga “Komuna e Mitrovicës” do të bëhet pas përfundimit të aktivitetëve, dorëzimit të raportit si dhe kërkesës për pagesë nga IADK-ja.
- Pagesa do të bëhet në TEB Bankë në depozitim në Nr.xhir:2027-000021-7128-84, në emër të IADK-së

III. Përkrahja e shërbimeve këshillimore dhe trajnimeve për fermerët e “Komunës së Mitrovicës”

- “Komuna e Mitrovicës” do të angazhoj sipas mundësive buxhetore “IADK”-në në ofrimin e shërbimeve këshillimore për fermerët në sektorin e blegtorisë (lopë, dele, dhi dhe bletë), hortikulturës (pemë, perime dhe bimë mjekësore) dhe përpunimit shtëpiak (përpunimin e qumështit, pemëve dhe perimeve) dhe trajnimeve ekonomike për fermerë.
- “Komuna e Mitrovicës” do të caktoj numrin e fermerëve për shërbime këshillimore dhe trajnime për të gjithë sektorët e bujqësisë por gjithmonë në vartësi nga plani i punës dhe bugjeti komunal;
- “IADK” së bashku me “Komunën e Mitrovicës” do të caktoj në numrin e sesioneve dhe temat e trajnimit për secilin sektor;
- “IADK” do të ofroj shërbime këshillimore për të gjithë fermerët direkt në fermë dhe do të bëjë monitorimin e rregullt të fermerëve të përzgjedhur;
- “IADK” do të ju ofroj trajnime praktike në model fermat për lopë dhe dhi, pemishtet intensive, serrat dhe pikat përpunuese të ushqimit;
- “IADK” do të pajisë fermerët me materiale edukuese në secilën temë të trajnimit;
- “Komuna e Mitrovicës” së bashku me “IADK”-në pajtohen që kostoja e shërbimeve këshillimore dhe trajnimeve të jetë (45 % Komuna e Mitrovicës dhe 55 % IADK);
- “Komuna e Mitrovicës” së bashku me “IADK”-në do të caktoj çmimin e shërbimeve këshillimore për fermerë dhe do t’i bashkëngjiten si aneks II kësaj Mpb për vitet kur do të këtë angazhime IADK-ja;
- “Komuna e Mitrovicës” sipas mundësive buxhetore dhe nevojave për fermerë së bashku me “IADK”-në për çdo vit deri në vitin 2021 do të nënshkruajnë ANEKS II në të cilin do të përcaktohet numri i fermerëve dhe i sektorëve që do të përkrahen;

IV. Bashkëfinancimi i projekt propozimeve nga donatorët e ndryshëm

- “Komuna e Mitrovicës” dhe “IADK”-ja pajtohen që të përkrahen njëra-tjetrën në aplikimet për projekte të ndryshme të cilat janë në interes të “Komunës së Mitrovicës” dhe “IADK”-së dhe të cilat zbatohen në “Komunën e Mitrovicës”;
- “Komuna e Mitrovicës” do të përkrahë “IADK”-në në bashkëfinancimin e projekteve nëse aprovohen nga donatorët e ndryshëm të cilat janë në interes të Komunës së Mitrovicës;
- “Komuna e Mitrovicës” në bashkëpunim me IADK-në do të bëjnë përgatitjen e projekt propozimeve të cilat janë në interes të komunës dhe do të përkrahen në vlerën e shumës së pranuar nga donatori në përgatitjen e projekt propozimit.





- “Komuna e Mitrovicës” së bashku me “IADK”-në do të caktojë obligimet dhe përgjegjësit si dhe shumën e kompensimit të cilat do të paraqiten në aneksin e veçantë;

V Përgjegjësit tjera

- “IADK” do të raportoj tek “Komuna e Mitrovicës” për rezultatet e arritura nga aktivitetet e realizuara në kuadër të MpB;
- “Komuna e Mitrovicës” do të bëjë pagesën për aktivitetet e kryera në varësi nga projektet që bashkëfinancohen një deri dy herë në vit, të cilat janë paraparë në këtë MpB;

VI Personat Kontaktues

“IADK”-ja dhe “Komuna e Mitrovicës” do të emërojnë nga një përfaqësues që të rregullojnë kontaktet më të lehta dhe të drejtpërdrejta në mes dy partnerëve. Këta persona do të përfshihen drejt për së drejti në implementimin e qetë dhe kohor të kësaj MpB.

VII Hyrja në fuqi dhe ndërprerja

Kjo MpB vlen nga muaji Janar 2019 deri në Dhjetor 2021, dhe hynë në fuqi duke filluar nga data e nënshkrimit nga të dy palët.

Palët pajtohen që për çdo vit kalendarik të përgatisin aneksin për planin e zbatimit të kësaj MpB.

Për modifikimin e kësaj MpB palët duhet të vendosin para skadimit të afatit.

Në rast të mosmarrëveshjes/pakënaqësisë nga ndonjëra palë, MpB mund të ndërpritet para afatit të paraparë duke dhënë një njoftim me shkrim 1- muaj më parë.

VIII Mospajtimet

Të dy palët në çdo kohë do të respektojnë dhe nderojnë kodin e sjelljes të partnerit të tyre, me kujdes të veçantë në pozicionet e paraqitura më lartë.

Iniciativa për Zhvillimin e Bujqësisë së Kosovës (IADK)

Zenel Bunjaku
Drejtor Ekzekutiv

Vushtrri 29/01 2019

Komuna e Mitrovicës

Agim Bahtiri
Kryetar

Mitrovicë 29.01 2019

